



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT, SHËNDETIT PUBLIK

Nr. 19521/1 Prot

Shkodër, më 19.4.2019

Lënda: Kthim përgjigje

Znj. [Emri i personit]

KRYETARE E KOMISIONIT TË SHËRBIMEVE SOCIALE DHE STREHIMIT E
KËSHILLIT BASHKIAK, SHKODËR

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.19521 prot. datë 13.11.2019, ku kërkohet informacion në lidhje me situatën e konvikteve të shkollave të qytetit ju sqarojmë si më poshtë:

Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit “Për strehimin e jetimëve në qytetin e Shkodrës” me Ministrinë e Zhvillimit Urban nr. 269 prot. datë 713/2016 me propozim të Bashkisë Shkodër, është realizuar rikonstruksioni i ish Konviktit të Shkollës Pyjore dhe përshtatja e ambjenteve për banesa sociale me qira për kategorinë e jetimëve të patrajtuar më parë me strehim dhe familjeve me një prind që jetojnë në situatë të vështirë social ekonomike. Janë 26 banesa sociale me qira ku do të përfitojnë rreth 50 individë.

Në zbatim të procedurave administrative për zbatimin e programeve sociale të strehimit dhe konkretisht programin e banesave sociale me qira për kategorinë e jetimeve dhe familjeve njëprindërore në ish Konviktin e shkollës Pyjore, Bashkia me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 25 datë 30.3.2017 ka miratuar vendimin “Për ndryshim e destinacionit të përdorimit të pronës “Konvikt i shkollës Pyjore” dhe kalim në fondin banesa sociale me qira” dhe në vijim me shkresë nr. 18254/1 prot. Datë 14.12.2017, Bashkia Shkodër i është drejtuar Ministrisë përgjegjëse “Për heqjen e kushtit të përdorimit të pronave si “prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore”, por nuk kemi një përgjigje zyrtare.

Më pas Administrata e Bashkisë Shkodër vijoj punën për realizimin e procedurave për programet e strehimit social sipas ligjit:

- Administrata e Bashkisë ka hartuar dhe propozuar për miratim Rregulloren për përbërjen dhe funksionimin e Komisionit të Strehimit, i cili u miratua me “Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 36 date 30.05.2017 “Për miratimin e rregullores “Për përbërjen dhe funksionimin e Komisionit të strehimit të Bashkisë”. Në vijim të shumë diskutimeve në lidhje me ligjshmerinë dhe përkatësinë e këtij Komisioni, Këshilli Bashkiak vendosi që ky Komision të ketë një afat 1 vjeçar.
- Në zbatim të VKB-së së mësipërm, u ngrit Komisioni i Strehimit me Urdher të Kryetares nr. 585 datë 18.8.2017 “ Për ngritjen e Komisionit të Strehimit të Bashkisë shkodër”. Në përbërje të këtij Komisioni konform VKM –së 574 datë 29.8.2012 “Përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njësit prej programeve të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, janë të përfshira dhe organizatat të shoqërisë civile sipas grupeve të interesit përkatës.
- Në vijim Komisioni i Strehimit hartoi dhe paraqiti për miratim pranë Këshillit Bashkiak, Projekt vendimin për miratimin e Sistemeve Pikëzimit për të gjitha programet sociale të strehimit. Ky projekt vendim pas shume diskutimeve nuk u miratua.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri nr. 22/2018 “Për strehimin social”, dhe së fundmi me miratimin e akteve nënligjore, jemi në proces të hartimit të projekt vendimeve në përputhje me ndryshimet ligjore dhe paraqitjen për miratim në Këshill Bashkiak, për t'i hapur rrugë zbatimit të programeve sociale të strehimit.

Në mbledhjen e radhës së K.B. do të diskutohet projekt vendimi për miratimin e formularit të aplikimit për programet sociale të strehimit, ndërkohë po punohet për hartimin e sistemeve të pikëzimit dhe propozimin për miratim pranë Këshillit Bashkiak.

Aktualishtë në Konviktin e Shkolles “Arben Broci” jetojnë këto familje:

1. Artan Miluka.
2. Leonard Kulla.
3. Fatmir Laska.
4. Zamir Brunga me gruan dhe dy fëmijë.
5. Astrit Guri.
6. Spartak Sofija.
7. Elvis Sofija.


Ndërsa në konviktin “Safet Spahija” jetojnë këto familje:

1. Marjan Thana me gruan dhe 5 fëmijë.
2. Tusha Kraja.

3. Drita Doci me dy fëmijë.
4. Astrit Staka me gruan dhe dy fëmijë.
5. Kujtim Bajrami.
6. Ardjan Dushi.
7. Loreta Paco.
8. Sonila Dervishi.
9. Diamanta Shega.
10. Teuta Pendavini.
11. Flutura Hyseni.
12. Ardjana Abazi.
13. Ardita Hoxha.

Në ç'do rast jemi të hapur për të dhënë ç'do informacion të nevojshme dhe për sygjerime!

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!


KRYETAR
Vollona Ademi